

VENDIM
Nr.366, datë 14.6.2006

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8321, datë 2.4.1998 “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë për gradë (kolona 3), e lidhjes nr.1, është niveli i pagës së punonjësit të Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën, që ka fituar.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolonat 4 e 5), të lidhjes nr.1, jepet sipas funksioneve të veçanta të Policisë së Burgjeve.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

5. Vendimi nr.54, datë 27.2.1992 i Këshillit të Ministrave “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar, duke filluar nga data 1 korrik 2006 nuk do të zbatohet për punonjësit e Policisë së Burgjeve.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

ROLI	GRADA	PAGA BAZË PËR GRADË	SHITESA PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE E SHËRBIMI	
			Në funksion të policie të regjimeve të jashtme	Në funksion të policie të regjimeve të brendshme dhe transferim shoqërimet
1	2	3	4	5
Bazë	Agjent	29000	4000	7000
	Agjenti i I-rë	30180	4000	7000
	Asistent	31300	4000	8000
	Asistent i I-rë	32500	4000	8000
	Kryeasistent	33600	4000	8000
I mesëm	Nëninspektor	43300	4000	6000
	Inspektor	45600	4000	6000
	Kryeinspektor	51480	4000	6000
I lartë	Nënkomisar	63180	4000	6000
	Komisar	78390	4000	6000
	Kryekomisar	90090	4000	6000
Madhor	Drejtues	100 500	8000	
	Drejtues i I-rë	103 500	8000	